MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR, TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në ***Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH Tiranë,*** me objekt: "*Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, për periudhën 1/1/2010 deri me 30/9/2011"* dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 57, datë 03/05/2012. Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 425/5, datë 03/05/2012 dërguar ***Z. Mihal Naço Drejtor i Drejtorisë së Pergjithshme të SHSSH Tiranë,*** krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të merren masa për të rivlerësuar, analizuar dhe rivendosjen në afat, nga ana e institucionit të detyrave të parealizuara dhe ato në proces, duke programuar masa afatshkurtra për realizimin e tyre.

Menjëherë

2. Të merren masa nga strukturat përkatëse të SHSSH-së në bashkëpunim me MPÇSSHB, për të bërë programimin e fondeve për trajtimin me ndihmë ekonomike të familjeve, me synim përcaktimin e nevojave vjetore, duke u bazuar në studimet konkrete dhe të dhënat e marra nga njësitë e qeverisjes vendore.

Vazhdimisht

3. Të merren masa për largimin nga skema e përfitimeve të ndihmës ekonomike të 4041 familje, sipas njësive të qeverisjes vendore, pasi për vitin 2011 janë trajtuar në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 9355, datë 10/3/2005, VKM nr. 787, datë 14/12/2005, Udhëzimit të MPÇSSHB nr. 338/3, datë 10/3/2006 "Mbi zbatimin e VKM nr. 87, datë 14/12/2005 "Përcaktimin e kritereve, procedurave dhe masës së ndihmës ekonomike".

Menjëherë

4. Të merren masa për të eleminuar vonesat e akordimit të fondeve, të cilat kanë sjellë pasoja, në mos pagesën e ndihmës ekonomike dhe ndihmës sociale në muajt e fundit të vitit, duke krijuar probleme të ndjeshme sociale për kategoritë e përfituesve, siç u konstatua në dy shkresat e fundit numër 1108/5, datë 8/9/2011 dhe 1108/8, datë 14/9/2011, me të cilat janë kryer përkatësisht pakësime dhe shtesa

në të njëjtin zë të shpenzimeve, ç'ka tregon për mungesë të studimit të lëvizjes së fondeve.

Menjëherë

5. Të merren masa për të hartuar programe të plota dhe të studiuara në drejtim të rritjes së fondeve për të gjitha institucionet në varësi të SHSSH, me synim garantimin e standardeve të shërbimeve, kushteve materiale e infrastrukturës së nevojshme, për 1038 klientët rezidencial dhe ditor të 27 institucioneve të përkujdesjeve shoqërore, në të cilat trajtohen fëmijët jetim, të moshuar të braktisur dhe fëmijët me aftësi të kufizuar etj.

Menjëherë

6. Të merren masa që Zyrat Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror të hartojnë një datebaze në lidhje me familjet që largohen nga skema e ndihmës ekonomike, si dhe shumën e përfituar padrejtësisht. Databaze i hartuar nga çdo Zyre Rajonale të dërgohet pranë Shërbimit Social Shtetëror (Drejtoria e Kontrollit) me qëllim hartimin e një datebaze të përgjithshëm dhe ndjekjen e tyre.

Brenda vitit 2012

7. Të merren masa që Zyrat Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, të njoftojnë Drejtorinë e Kontrollit, për vjeljen e detyrimeve për çdo familje dhe shumën përkatëse, me qëllim realizimin e detyrave dhe shlyerjen e detyrimeve si dhe për heqjen e saj nga lista e debitorëve.

Brenda vitit 2012

8. Të merren masa që të analizohen nga Këshilli Administrativ i institucionit, pasqyrat financiare për vitin 2010 dhe 2011, sipas detyrimeve të nenit 14, germa "b" të Statutit të SHSSH, miratuar me VKM nr. 542, datë 27/7/2005 "Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror", ku përcaktohet se: "Këshilli Administrativ miraton bilancin, raportin vjetor dhe projekt- buxhetin për vitin pasardhës". Këshilli Administrativ nuk ka aprovuar bilancin vjetor të Shërbimit Social Shtetëror për vitin 2010, si dhe bilancin e konsoliduar me të gjitha institucioneve në varësi.

Menjëherë

9. Të merren masa që Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme të fillojë menjëherë procedurat përkatëse të regjistrimit të pasurisë në ZVRPP, pasi nuk disponohen Certifikatat e Pronësisë për objektin "Ndërtesë", pronë e patundshme e këtij institucioni, siç përcaktohet në kërkesat e VKM nr. 620, datë 15/9/2006 dhe nenin 11 të ligjit nr. 7843, datë 13/7/1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

Brenda muajit Maj 2012

10. Të merren masa për të vendosur në kushte arkëtimi, detyrimin prej 25,593 lekë, në Komunën Buçimas i krijuar nga muaji mars 2009, pasi 25 familje sipas vendimit të Këshillit të Komunës nr. 17, datë 17/4/2009 kanë përfituar padrejtësisht në kundërshtim me pikën 18, të VKM nr. 787, datë 14/12/2005, nga mospërputhja e të dhënave mbi masën e ndihmës ekonomike ndërmjet projekt-vendimit dhe vendimit të Këshillit të Komunës. Kjo gjendje e përfshirjes së familjeve në skemën e ndihmës nga ana e Këshillit të Komunës, jashtë propozimeve të Zyrës së Ndihmës Ekonomike ka vijuar dhe gjatë vitit 2011, prandaj SHSSH të kryejë një auditim të plotë të këtyre rasteve.

Brenda 6/mujorit të parë 2012

11. Të merren masa që të hiqen nga skema e ndihmës ekonomike, 41 familje me efekt financiar 105,300 lekë në Komunën Hudënisht të Pogradecit, pasi nga kontrolli i ushtruar nga Dega Rajonale e SHSSH Korçë me datë 28/9/2011 është konstatuar se mungojnë konfirmimet e institucioneve shtetërore mbi gjendjen e familjarëve, duke vepruar në kundërshtim me pikat 22 dhe 23 të VKM nr. 787, datë 14/12/2005, si dhe Udhëzimin e MPCSSHB nr. 338/3 datë 10/3/2006.

Brenda 6/mujorit të parë 2012

12. Të merren masa që të ndërmerren veprimet përkatëse pezulluese nga Kryetari i Komunës Hudënisht për 52 familje që janë trajtuar për vitin 2009, me efekt financiar prej 160,800 lekë, paguar në kundershtim me pikën 2, germa "ç" dhe "d" të VKM nr. 787, datë 14/12/2005, pasi nuk janë pajisur me certifikatë të pronësisë së tokës nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Brenda 6/mujorit të parë 2012

13. Të merren masa për hartimin nga Sektori i Auditimit të SHSSH, të manualit me veçoritë specifike për auditimin e sistemit të administrimit të Ndihmave Ekonomike (NE) dhe Paaftësisë së Kufizuar (PAK), detyrim ky që rrjedh nga neni 18/1 i ligjit nr. 9720, datë 23/4/2007 i ndryshuar, dhe pika 2 e urdhrit nr. 69, datë 29/9/2010 të Ministrit të Financave "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm të sektorit publik", duke përfshirë teknikat e kryerjes së auditimit, ripunimin e normave të veçanta të auditimit sipas fushave konkrete, dhe të miratohet ky Manual nga Ministri i Financave.

Brenda 6/mujorit të parë 2012

14. Të merren masa nga DAB dhe NJQHAB për programimin e trajnimeve të detyruara për audituesit mbi Manualin e ri, procesin e formimit profesional dhe edukimin e përditësuar, pasi vërejmë se gjatë vitit 2010 nuk janë kryer trajnime të detyrueshme, që sipas normave të Manualit të Audtimit janë 50 orë në vit. Këto trajnime të detyrueshme të bazohen në nevojat e audituesve, detyrim ky sipas nenit

20 të Ligjit nr. 9720, ku nënvizohet se *"Të gjithë audituesit në detyrë, ..., i nënshtrohen edukimit të përditësuar, trajnimit të vijueshëm e të detyrueshëm..."*.

Vazhdimisht

15. Të merren masa për programimin me përparësi auditimit të objekteve me prapambetje në ushtrimin e auditimit, pasi për vitin 2010 rezultonin dy objekte me prapambetje tej afatit 2 vjeçar pa u audituar nga ana e kësaj njësie, situatë që ka vijuar edhe për vitin 2011, duke mos përmbushur në këtë mënyrë detyrimin e përcaktuar në Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Brenda 6/mujorit të parë 2012

16. Të merren masa për planifikimin e kostos së auditimit për çdo mision angazhimi, por të mos mbetet kjo vetëm një tregues plani, meqenëse në asnjë dosje nuk u gjet një skedë/tabelë e përllogaritjes së kostove efektive në një mision, me qëllim që në fund të vitit bëhen analizat e përgjithshme mbi efektivitetin dhe ekonomicitetin.

Vazhdimisht

17. Të merren masa për planifikimin e kryerjes së misioneve të angazhimit në Drejtoritë apo sektorët e veçantë të Drejtorisë së Përgjithshme nga ana e sektorit të auditimit, si shërbim i dhënies së sigurisë dhe këshillimit pranë Drejtorit të Përgjithshëm.

Brenda 6/mujorit të parë 2012

18. Të merren masa për ndjekjen sipas një plani të veçantë tematik zbatimi i rekomandimeve të lëna nga struktura e auditimit, në përputhje me përcaktimet e pikës nr. 3.2.1, Kreu III të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 69, datë 29/9/2010 të Ministrit të Financave, meqenëse në disa auditime janë konstatuar neglizhenca në programimin e detyrave, kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të lëna nga auditimi etj.

Periodikisht

19. Të merren masa për realizimin e përmirësimeve të nevojshme strukturore e organizative, që Sektori i Auditimit të Brendshëm të raportojë para Këshillit Administrativ të SHSSH, në zbatim të detyrimit normativ të pavarësisë, parashikuar nga Standardi Ndërkombëtar Atributiv nr. 1100 i Institutit të Audituesve të Brendshëm, ku sanksionohet se *"Shefi ekzekutiv i auditimit duhet të raportojë në një nivel brenda organizatës, i cili lejon që aktiviteti i auditimit të brendshëm të përmbushë përgjegjësitë e tij"*.

Brenda muajit Korrik 2012

20. Të merren masa që të bëhen trajnimet për të gjithë punonjësit, të cilët janë të angazhuar direkt me menaxhimin e skemës së ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, sepse ndryshimet e shpeshta të bëra në administratorët shoqëror në njësitë vendore, e bëjnë të nevojshëm zhvillimin e tyre.

Vazhdimisht

B. <u>MASA PËR SHPËRBLIM DËMI</u>

1. Të merren masat dhe të ndiqen procedurat ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik **në shumën 4,750 lekë,** nga [redacted] të marrë padrejtësisht gjatë vitit 2011, në kundërshtim me VKM nr. 787, datë 14/12/2005 dhe udhëzimin nr. 1053 "Për llogaritjen e të ardhurave nga toka, blegtoria etj.", për sa përfituar më tepër pension pleqërie për periudhën 6/2/2008 deri më 15/4/2009.

<u>Shënim:</u> Auditimi u krye nga audituesit Zyhra Kepi Përgjegjëse Grupi, Pranvera Doçi, Qeram Cibaku dhe Raimond Koçi. Më tej u shqyrtua nga Kryeauditues i Departamentit zj. Luljeta Nano, Drejtori i Departamentit z. Ded Trieshi dhe Drejtore e Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë zj. Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT